

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8193
E premte, 28 nëntor 2025
Çmimi 0.50 €

Kurti: Municionet e para 'Made in Kosova' do të prodhohen në fund të vitit 2026

FACE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

'DITA E FORCËS', QYTETARËT NJIHEN ME USHTARËT DHE ARMATIMIN E FSK-së



Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ekspozoi armë dhe pajisje në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë më 27 Nëntor, në Ditën e Forcës. Udhëheqësit e lartë shtetërorë, qytetarë dhe nxënës të shkollave fillore dhe fëmijë kopshtesh, shkuan t'i shihnin nga afër ushtarët dhe pajisjet e tyre. FSK-ja aktualisht është në proces të transformimit në ushtri. Qeveria e Kosovës ka thënë se në katër vitet e fundit janë investuar mbi 400 euro vetëm për blerjen e pajisjeve të reja për FSK-në

VOTIMI JASHTË VENDIT ORGANIZOHET NË 50 PËRFAQËSI DIPLOMATIKE, ME GJITHSEJ 66 VENDVOTIME NË 36 SHTETE TË BOTËS

F. 3



LV-ja NOMINON KURTIN KANDIDAT PËR KRYEMINISTËR PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

F. 7



AKTUALE



RUBIO: FILLIMISHT PAQJA, PASTAJ GARANCITË E SIGURISË PËR UKRAINËN

F. 2

NDAHEN MBI KATËR MILIONË EURO PËR PAGAT E 700 PUNËTORËVE TË RTK-SË, KURTI E QUAN IMPROVIZIM TË DETYRUAR

F. 6

PARAQITET KURRIKULA E RE PËR EDUKIMIN NË FËMIJËRINË E HERSHME PËR MOSHËN 0-6 VJEÇ

F. 6

EKONOMI



ÇMIMET E PRODHIMIT, MË TË LARTA NË TREMUJORIN E TRETË TË KËTJ VITI

F. 8

RRITET KOSTOJA E NDËRTIMIT

F. 8

SPORT



QEVERIA NDAN 250 MIJË PËR KOMBËTAREN E KOSOVËS, ZOTOHET EDHE PËR NJË MILION NËSE KUALIFIKOHET NË BOTËTOR

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

RUBIO: FILLIMISHT PAQJA, PASTAJ GARANCITË E SIGURISË PËR UKRAINËN

UASHINGTON, 27 NËNTOR - Shtetet e Bashkuara u kanë bërë të qartë aleatëve të tyre evropianë se nuk do të ketë garanci sigurie për Ukrainën derisa të arrihet një marrëveshje paqeje. Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, e tha këtë gjatë bisedimeve me përfaqësues të BE-së, sipas dy burimeve të “Politico”-s që njihnin diskutimet. Ata thonë se Uashingtoni po thekson prioritetin e planit të tij për

paqen. Rubio u tha partnerëve se Donald Trump do t'i trajtojë garancitë afatgjatë të sigurisë më vonë - ato që synojnë të “sigurojnë një ndjenjë sigurie” për Kievin. Një diplomat tjetër evropian tha se Rubio e përmendi çështjen e garancive në takimin e Gjenevës më 23 nëntor, por nuk zgjati më tej mbi të - as në thirrjen e tij të mëvonshme me përfaqësuesit e Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës. Sipas

“Politico”-s, sekretari i shtetit gjithashtu renditi disa çështje që duhet të zgjidhen pas arritjes së një marrëveshjeje - zyrtarët evropianë besojnë se ai nënkuptonte “integritetin territorial” të Ukrainës dhe asetet e ngrira të Rusisë. Ndryshe Ukraina raportohet se ka arritur ta ndryshojë planin e paqes të propozuar nga presidenti amerikan Donald Trump i cili tani përbën 19 pikë nga 28 sa kishte më parë.



RRITET NUMRI I VIKTIMAVE NGA ZJARRI NË HONG KONG, POLICIA FAJËSON KOMPANINË E NDËRTIMIT PËR “NEGLIZHENCË”

HONG KONG, 27 NËNTOR - Një zjarr i madh ka përfshirë një kompleks banimi në Hong Kong, teksa numri i viktimave është rritur në të paktën 55 persona, ndërkaq afër 300 të tjerë konsiderohen të zhdukur. Policia tha më 27 nëntor se zjarri u shkaktua nga “neglizhenca e madhe” e një firme ndërtuese që përdori materiale të pasigurta. Pothuajse një ditë e plotë pasi nisi zjarri, zjarrfikësit ende nuk po mund të arrijnë te banorët që mund të jenë të bllokuar në katet e larta të kompleksit banesor Wang Fuk Court për shkak të nxehtësisë së madhe dhe shtëllungave të tymit. Policia tha se, përveç faktit që ndërtesat ishin të mbuluara me rrjeta mbrojtëse dhe plastikë që mund të mos i plotësojnë standardet e sigurisë nga zjarri, ata zbuluan se disa dritare që nuk ishin prekur nga zjarri ishin të mbyllura me një material prej shkume, që ishte instaluar nga



kompania e ndërtimit që po kryente punime të mirëmbajtjes që një vit. “Kemi arsye të besojmë se përgjegjësit e kompanisë kanë qenë jashtëzakonisht neglizhentë, gjë që çoi në këtë aksident dhe bëri që zjarri të përhapej në mënyrë të pakontrolluar, duke

shkaktuar viktima të shumta”, tha Eileen Chung nga Policia e Hong Kongut. Ajo shtoi se tre persona nga kompania e ndërtimit, dy drejtorë dhe një konsulent i inxhinierisë, janë arrestuar nën dyshime për vrasje nga pakujdesia në lidhje me zjarrin.

Të enjten në mëngjes oficerët e policisë kontrolluan kompaninë e mirëmbajtjes së ndërtesave të kompleksit të banimit, duke sekuestruar dokumente që përmendnin Wang Fuk Court, raportuan mediet lokale. Kompleksi banesor në qarkun verior Tai Po ka 2 000 apartamente në tetë blloqe, ku jetojnë më shumë se 4 600 persona, në një qytet që po përballet me mungesë kronike të banimit të përballueshëm. Të enjten në mëngjes autoritetet thanë se kishin vënë nën kontroll zjarrin në katër nga shtatë blloqet, ndërsa operacionet vazhdonin në tri blloqet e tjera. Pamjet nga vendngjarja, rreth 22 orë pasi kishte nisur zjarri, tregojnë se flakët po vazhdojnë në të paktën dy kulla 32-katëshe që janë të mbështjella me një rrjet të gjelbër ndërtimi dhe me skelë prej bambuje. Skela prej bambuje është një element tradicional i

arkitekturës kineze, por ka nisur të hiqet gradualisht në Hong Kong që nga muaji mars, për arsye sigurie. Një zjarrfikës është mes 55 të vvarëve, ndërsa 45 persona që janë në spital janë në gjendje kritike, tha policia në Hong Kong në një konferencë për medie të enjten. “Prioriteti ynë është shuarja e zjarrit dhe shpëtimi i banorëve të bllokuar”, u tha gazetarëve udhëheqësi i Hong Kongut, John Lee. “Së dyti, të mbështesim të plagosurit. Së treti, të ofrojmë mbështetje dhe rikuperim. Më pas, do të fillojmë një hetim të plotë”. Ai shtoi se rreth 279 persona konsiderohen të zhdukur dhe 900 të tjerë gjenden në tetë strehimore. Numri i viktimave nga kjo ngjarje është më i larti i shkaktuar nga zjarri në Hong Kong që nga viti 1948, kur 176 persona u vranë pasi një zjarr shpërtheu në një depo.

RUMANIA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE PËR BLERJEN E SISTEMEVE FRANCEZE TË MBROJTJES AJRORE

BUKURESHT, 27 NËNTOR - Ministria e Mbrojtjes e Rumanisë tha se do të blejë sisteme franceze të mbrojtjes ajrore, Mistral, në vlerë prej mbi 626 milionë eurosh, si pjesë e një marrëveshjeje të përbashkët prokurimi me disa shtete të tjera të Bashkimit Evropian. Ministria tha se e ka nënshkruar marrëveshjen me Ministrinë franceze të Mbrojtjes të martën për blerjen e 231 sistemeve të mbrojtjes ajrore Minstral (MANPADS) – që prodhohen nga kompania e raketave MBDA - dhe 934 raketa. Në marrëveshje përfshihen edhe trajnimet,

simulatorët dhe logjistika. Në njoftimin e lëshuar nuk u specifikua se kur këto pajisje do të dërgohen në Rumani. Ligjvënësit rumunë fillimisht kishin miratuar planin për blerjen e këtyre armëve më 2022. Rumania, shtet anëtar i BE-së dhe NATO-s, ndan një kufi tokësor me Ukrainën të gjatë prej 650 kilometrash. Ky shtet është përballur me shkelje të hapësirës ajrore dhe copëza të dronëve kanë rënë vazhdimisht që kur Rusia nisi sulmet ndaj porteve të Kievit përgjatë lumit Danub. Mbrojtja ajrore rumune aktualisht përfshin avionë

luftarakë F-16, sisteme Patriot, lëshues raketash HIMARS të prodhuara nga Lockheed Martin, raketa me rreze të shkurtër veprimi Chiron të Koresë së Jugut, dhe armë kundër avionëve Gepard, të prodhimit gjerman. Vendi, po ashtu, synon që të bashkëpunojë me Ukrainën për ndërtimin e dronëve nën një mekanizëm të ri të BE-së për financimin e mbrojtjes. Rumania, po ashtu, është në fazën finale të dislokimit të sistemeve kundër dronëve, Merops, që janë furnizuar nga Shtetet e Bashkuara.



VOTIMI JASHTË VENDIT ORGANIZOHET NË 50 PËRFAQËSI DIPLOMATIKE, ME GJITHSEJ 66 VENDVOTIME NË 36 SHTETE TË BOTËS

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Në mbledhjen e 84-t në këtë vit dhe në kuadër të përgatitjes së zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë vendim për miratimin e Qendrave të Votimit për votimin jashtë vendit, i cili do të mbahet më 27 dhjetor 2025, një ditë para ditës së zgjedhjeve në Kosovë. Sipas vendimit të KQZ-së, procesi i votimit planifikohet të organizohet në 50 përfaqësi diplomatike me gjithsej 66 vendvotime të vendosura në 36 shtete të botës. Megjithatë, kjo listë do të mund të rishikohet nga KQZ-ja, varësisht nga numri i votuesve që do të regjistrohen për të votuar në përfaqësi diplomatike. Gjithashtu, KQZ-ja ka caktuar numrin maksimal 950 votues që mund të regjistrohen për të votuar në një vendvotim në

përfaqësi diplomatike. Sipas vendimit të KQZ-së, numri maksimal i votuesve që mund të regjistrohen për të votuar në këto përfaqësi diplomatike është 62 700 votues. Po sipas vendimit të KQZ-së, Qendrat e Votimit do të hapen edhe në hapësira shtesë, jashtë përfaqësive diplomatike, sipas propozimit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Lokacionet shtesë përfshijnë 10 Qendra të Votimit (Gjermani 5; Zvicër 3, Mbretëri e Bashkuar 1 dhe ShBA 1) me gjithsej 43 vendvotime dhe me numër maksimal të votuesve që mund të regjistrohen për të votuar 40 850 votues. Në përgjithësi, numri i Qendrave të Votimit për votimin jashtë Kosovës, të miratuara nga KQZ-ja, është 60, me gjithsej 109 vendvotime. Ndërkaq numri maksimal i votuesve që mund të regjistrohen për të votuar në këto Qendra të Votimit është



103 550.

KQZ-ja sqaron se kufizimi i numrit maksimal të votuesve që mund të regjistrohen vlen vetëm për votimin në përfaqësi diplomatike, ndërkaq numri i votuesve që

mund të regjistrohen për votim përmes postës është i pakufizuar. Në rast të plotësimit të numrit maksimal të votuesve në përfaqësi diplomatike, sipas parimit të kohës së aplikimit,

aplikuesi do të udhëzohet për regjistrim për mënyrat e tjera të votimit përmes postës. Periudha e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës ka filluar më 26 nëntor dhe do të përfundojë më 6 dhjetor.

KQZ-ja CERTIFIKON REZULTATIN E BALOTAZHIT TË 9 NËNTORIT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatin për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale që u mbajtën në 18 komuna më 9 nëntor, duke i hapur rrugë marrjes së mandateve nga kryetarët e rinj në 38 komuna të Kosovës. Në raundin e parë, të mbajtur më 12 tetor, qytetarët zgjodhën kryetarët në 20 komuna të tjera. Gjatë mbledhjes anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje deklaruan se votojnë kundër certifikimit të rezultatit për kryetar komune në Kllokot. Bazuar në dy raundet e votimit, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kanë fituar nga shtatë komuna, Partia Demokratike e Kosovës



gjashtë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës pesë komuna dhe Lista Serbe dhjetë.

Lëvizja Vetëvendosje në raundin e dytë fitoi në Mitrovicë të Jugut, Fushë-Kosovë, Gjilan dhe Obiliq. Kjo

parti, që udhëhiqet nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, në raundin e parë mori udhëheqjen e Kamenicës, Podujevës dhe Shtimes. Në raundin e dytë, Lidhja Demokratike e Kosovës fitoi në pesë komuna: Prishtinë, Pejë, Dragash, Viti dhe Junik. Në raundin e parë kjo parti fitoi në Istog dhe Lipjan. Partia Demokratike e Kosovës në balotazh fitoi në Prizren, Vushtri dhe Kaçanik, ndërkaq më 12 tetor, kjo parti fitoi në Skenderaj, Ferizaj dhe Han të Elezit. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës më 9 nëntor kori fitore në Gjakovë, Suharekë, Klinë dhe Rahovec. Partia e udhëhequr nga Ramush Haradinaj më 12 tetor, ndërkaq, fitoi në Deçan. Lista Serbe - partia kryesore e

serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit - është partia që ka fituar më së shumti vota, përkatësisht 10 komunat e banuara me shumicë serbe. Në raundin e balotazhit, ajo fitoi në Kllokot, ndërkaq më 12 tetorit mori drejtimin në Leposaviq, Novobërdë, Shtërpçë, Zubin Potok, Zveçan, Graçanicë, Ranillug, Partesh dhe Mitrovicë të Veriut. Partia turke, KDTP, në balotazh fitoi në Mamushë. Ndërkaq, Nisma Socialdemokrate në raundin e parë ka fituar në Malishevë, ndërkaq në Drenas ka fituar nisma e Ramiz Lladrovci. Dalja në raundin e parë ishte mbi 40 për qind, ndërkaq në balotazh mbi 32 për qind. Dy raundet e votimit u zhvilluan pa ndonjë incident të madh.

Kamberi në Kuvendin e Serbisë paraqet kërkesat e Luginës

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Deputeti Shaip Kamberi gjatë një debati për buxhetin në Kuvendin e Serbisë foli për problemet që kanë qytetarët në Luginën e Preshevës, si: pasivizimi i adresave, diskriminimi institucional ndaj shqiptarëve, moszbatimi i ligjit për përdorimin zyrtar të gjuhëve etj. Kamberi në rrjetin social në "Facebook" ka bërë me dije se e ka pyetur Ministrinë e

Brendshme pse nuk i ka kthyer përgjigje në kërkesën e tij që komuna e Preshevës ta marrë targën e saj të regjistrimit për automjetet motorike. Gjithashtu, Kamberi pyeti qeverinë pse janë bllokuar paratë për Këshillin Kombëtar Shqiptar nga fondet e Qeverisë së Kosovës si dhe çfarë po ndodh me iniciativën për një program për pranimin e personave nga pakicat kombëtare shqiptare dhe

boshnjake në shërbimin policor në nivel lokal. Edhe në seancën e kaluar, deputeti shqiptari foli me tone të ashpra në parlamentin serb. "E dimë se ekziston diskriminim institucional ndaj shqiptarëve në Luginën e Preshevës. E dimë se ekziston praktika e pasivizimit të adresave përmes së cilës mijëra njerëzve u hiqet e drejta zgjedhore dhe qytetare", nënvizoi Kamberi.





‘DITA E FORCËS’, QYTETARËT NJIHEN ME USHTARËT DHE ARMATIMIN E FSK-së

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ekspozoi armë dhe pajisje në kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë më 27 Nëntor, në Ditën e Forcës. Udhëheqësit e lartë shtetërorë, qytetarë dhe nxënës të shkollave fillore dhe fëmijë kopshtesh, shkuan t’i shihnin nga afër ushtarët dhe pajisjet e tyre. FSK-ja aktualisht është në proces të transformimit në ushtri. Qeveria e Kosovës ka thënë se në katër vitet e fundit janë investuar mbi 400 euro vetëm për blerjen e pajisjeve të reja për FSK-në

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Në kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë u mbajt “Dita e Forcës”. Dyert e ushtrisë u hapën për të gjithë qytetarët që dëshironin t’i shihnin nga afër pajisjet ushtarake dhe strukturën e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka thënë se sot është

një ditë krenarie për vendin. “Gëzuar Dita e Ushtrisë sonë! Sot është një ditë krenarie sepse ushtria jonë e sotme është pasardhëse e denjë dhe krenare e UÇK-së. Në radhët e ushtrisë sonë çdo ditë po shtohen djem e vajza që duan t’i shërbejnë atdheut. Së bashku do të ecim përpara për ta bërë ushtrinë tonë që çdo ditë e mbron shtetin tonë me sakrificë”, ka thënë ajo.

Ndërsa ish-kryekuvendari

Dimal Basha përshëndeti kontributin e FSK-së, duke thënë se ka bërë një punë të jashtëzakonshme. “Ushtria jonë është vazhdimësi e lavdishme e popullit tonë. Jemi jashtëzakonisht krenar që FSK-ja mbetet institucioni më i besueshëm në vend. Shpresoj që kjo punë e mirë të vazhdojë për një ushtri paqedashëse dhe për të gjithë ata që ranë për vendin tonë”, ka thënë ai.

Edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka folur për rëndësinë e mbrojtjes dhe sigurisë. “Patëm nderin dhe kënaqësinë që ta vizitojmë FSK-në në prezantimin e armatimit. Kjo na bën krenar që të ndihemi të sigurt. Kjo është një ditë e lumtur për të gjithë ne, sepse me FSK-në dhe me këtë ushtri të pajisur kaq mirë, brezat e rinj do të jenë të sigurt që të jetojnë në paqe dhe të lulëzojnë”, është shprehur ai.

Kurti nënvizoi se FSK-ja sot është shumë më e pajisur se më parë. “Më përpara ushtria jonë ka pasur vetëm automatikë dhe revole, ndërsa tani FSK-ja është e pajisur me pajisje moderne... kemi më shumë se dyfishim të kapaciteteve. Po ashtu, planifikojmë të marrim edhe helikopterë tip ‘Black Hawk’ nga aleatët tanë, veçanërisht nga Shtetet e Bashkuara”, ka pohuar ai.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim



KURTI: MUNICIONET E PARA ‘MADE IN KOSOVA’ DO TË PRODHOHEN NË FUND TË VITIT 2026

Qeveria në detyrë e Kosovës më 27 nëntor miratoi kërkesën për shpronësimin e pronave të ish-kombinatit bujqësor “Ereniku” për ndërtimin e zonës industriale në Jahoc të Gjakovës, ku do të ndërtohet fabrika e municioneve. “Me këtë hapim rrugë në terren për ndërtimin e fabrikës së municioneve, të parës së llojit të saj në Kosovë që do t’i shërbejë ushtrisë sonë, do ta rrisë sigurinë tonë dhe do t’i ngrehë edhe më tej kapacitetet tona mbrojtëse”, ka deklaruar Kurti të enjten gjatë mbledhjes së kabinetit qeveritar

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, tha se municionet e para të fabrikës së municioneve që do të ndërtohet në Gjakovë do të prodhohen në fund të vitit 2026. Qeveria në detyrë e Kosovës më 27 nëntor miratoi kërkesën për shpronësimin e pronave të ish-kombinatit bujqësor “Ereniku” për ndërtimin e zonës industriale në Jahoc të Gjakovës, ku do të ndërtohet fabrika e municioneve. “Me këtë hapim rrugë në terren për ndërtimin e fabrikës së municioneve, të parës së llojit të

saj në Kosovë që do t’i shërbejë ushtrisë sonë, do ta rrisë sigurinë tonë dhe do t’i ngrehë edhe më tej kapacitetet tona mbrojtëse”, tha Kurti në fillim të mbledhjes. Nëntorin e vitit të kaluar qeveria kishte njoftuar për nisjen e procesit për hapjen e një fabrike për prodhimin e municionit dhe për laboratorë për dizajnimin e fluturakeve pa pilotë, të njohura si dronë. Dhjetorin e po atij viti Qeveria e Kosovës nënshkroi marrëveshje me prodhuesin turk të industrisë Makine ve Kimya Endüstrisi për themelimin e një fabrike të municioneve në Kosovë. “Ndërtimi i kësaj fabrike, për të



cilin kemi kontratë të nënshkruar me prodhuesin turk MKE, do të përfundojë brenda vitit të ardhshëm. Municionet e para nga kjo fabrikë do të dalin në fundin e vitit 2026. Përveç fabrikës së municioneve, kjo zonë industriale do të shërbejë edhe për investitorë të tjerë me të cilët jemi në kontakt dhe do të prodhojmë lloje të ndryshme të produkteve ushtarake, dronët ushtarakë dhe civilë ‘Made in Kosova’, tha Kurti. Ai tha se gjatë mandatit katërvjeçar, Forca e Sigurisë së Kosovës, që sot shënon ditën e saj,

është pajisur me pajisje moderne. Gjatë kësaj periudhe mbi 430 milionë euro kanë shkuar për blerje të armatimit për FSK-në. Vitet e fundit Kosova ka rritur buxhetin për mbrojtje dhe së voni vendi ka pranuar dronë, autobllinda dhe pajisje të tjera që i ka blerë nga prodhues të ndryshëm amerikanë. FSK-ja është aktualisht në proces të transformimit në ushtri të rregullt. Deri në fund të këtij procesi, më 2028, FSK-ja pritet t’i ketë mbi 7 500 pjesëtarë aktivë dhe rezervistë nga mbi 4 000 sa i

ka aktualisht. Po në Ditën e Forcës, Kurti ka thënë se kjo ditë na gjen më të fortë se kurrë më parë. “Mbi 430 milionë euro është investimi në armatim dhe pajisje në këto katër vitet e fundit. Më përpara ushtria jonë ka qenë më pak e pajisur edhe se Policia e Kosovës, ndërkaq tani është e pajisur me teknologji moderne, me dronë Skydagger dhe TB-2 Bayraktar nga Turqia, Puma dhe sistem anti-tank Javelin nga ShBA, e së shpejti do të kemi fabrikë të municionit dhe prodhimin e dronëve Made in Kosova e helikopterë Black Hawk nga ShBA. Me Forcën e Sigurisë së Kosovës, me këtë ushtri të pajisur kaq mirë e gjithnjë e më shumë, brezat e rinj jetojnë të sigurt, në paqe, zhvillohen dhe lulëzojnë. Gëzuar të gjithëve Dita e Forcës, 27 nëntori, dhe një falënderim i veçantë për aleatët tanë, NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe oficerët, nënoficerët, ushtarët e ushtarët tanë, të cilët edhe në ditë të festave shërbejnë për sigurinë dhe mirëqenien e të gjithëve pa dallim. Urime!”, ka thënë Kurti.

HAPET EKSPOZITA “KOHA E SHNDËRRIMIT, KOSOVA - 1968-1981: DOKUMENTE DHE DËSHMI” E ORGANIZUAR NGA ASHAK-U

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, mori pjesë në hapjen e ekspozitës “Koha e shndërrimit - Kosova 1968-1981: dokumente dhe dëshmi”, organizuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK) në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Me një fjalë rasti para të pranishmëve, kryeministri Kurti tha se ashtu si titulli i ekspozitës, ka qenë edhe periudha në harkun kohor nga viti 1968 deri në vitin 1981, kur rinia shqiptare, në të njëjtën kohë, sikurse protestuesit në Pragë, që i hapën rrugën një kapitulli të liberalizimit dhe Paris, që nga një lëvizje studentore u kthye në një revolucion shoqëror, u ngrit në protesta duke kërkuar liri, të drejtat e tyre dhe duke brohoritur “Universitet” dhe “Vetëvendosje”. Demonstratat e vitit 1968, tha kryeministri Kurti në fjalën e tij,



hapën rrugë për avancimin e të drejtave kulturore dhe politike të shqiptarëve në Jugosllavi por, në anën tjetër, ishin edhe një ngjarje prej nga lindi një gjeneratë e tërë e aktivistëve të paepur, shumë prej të cilëve përfunduan nëpër burgje, sikurse Adem Demaçi dhe Rexhep Mala. Ai tha se edhe pse vitet për

Kosovën pas Autonomisë së vitit 1974, që e ngriti Kosovën në nivel të krahinës autonome dhe konstituive Federatës jugosllave, në dukje prosperuese e të qeta, u shembën si rezultat i shtypjes, shfrytëzimit dhe të diskriminimit sepse, ndonëse mori hov zhvillimi ekonomik, vazhonte të thellohej pabarazia, nënperfaqësimi i

shqiptarëve në Kosovë dhe jo vetëm. “Në pranverën e vitit 1981, gjatë marsit dhe prillit të atij viti, fillimisht studentët e Universitetit të Prishtinës e pastaj edhe punëtorët e masat e gjera popullore, u ngritën në një sërë protestash, të cilat shënuan një ngjarje tjetër kapërcyese në historinë e re të Kosovës”, tha kryeministri Kurti, për të shtuar më tej se historia e këtyre viteve dhe e këtij shndërrimi është e lexueshme në dokumentet e ekspozuara aty në mesin e dokumenteve të përzgjedhura nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. E duke i parë këto dokumente, kryeministrit theksoi se shohim se sa i rëndësishëm është investimi në institucionet tona arkivore, si në infrastrukturë po ashtu edhe në teknologji, njëkohësisht edhe si kultivim i

kulturës së arkivimit, si traditë institucionale. “Arkivat e shtetit tonë përveçse na tregojnë çfarë ishte e kaluara në formë të dokumenteve dhe xhirimeve e incizimeve, në të njëjtën kohë na e inkurajojnë shoqërinë tonë që sa më shumë të mbajnë shënime, që sa më shumë të dokumentojnë për ata që do të vijnë pas nesh, ashtu siç kanë bërë ata që ishin para nesh për brezin tonë” u shpreh ai. Në fund të fjalës së tij, kryeministri Kurti tha se duke e studiuar dhe mësuar mirë se prej nga vijmë, ne dimë të ecim më drejt, më shpejt, më qartë andej nga jemi nisur, prandaj arkivat e shtetit tonë, përveçse na tregojnë çfarë ishte e kaluara në formë të dokumenteve dhe xhirimeve e incizimeve, në të njëjtën kohë na e inkurajojnë shoqërinë tonë që sa më shumë të mbajnë shënime.



Jashari, duke uruar për “Ditën e Forcës” ushtarakët, pjesëtarët aktivë dhe ata rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes, ka uruar edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, duke

theksuar se FSK-ja që nga themelimi e deri më sot ka dëshmuar përkushtim, profesionalizëm dhe disiplinë në përmbushjen e misionit të saj për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të

Republikës së Kosovës, për mbështetjen e paqes, sigurisë dhe zhvillimit të vendit tonë. “Në këtë ditë të veçantë ju falënderoj për përkushtimin dhe sakrificën e përditshme në shërbim të atdheut! Urime të

gjithë pjesëtarëve të FSK-së! bashkë me nder e përkushtim do të vazhdojmë ta forcojmë Forcën tonë dhe ta mbrojmë atdheun tonë të dashur”, ka thënë Jashari. Në “Ditën e Forcës” shumë

qytetarë, përfshirë edhe fëmijë, vizituan kazermën. Ata kishin mundësi t’i takonin ushtarët, t’i shihnin pajisjet, në disa raste edhe të bënin fotografi me udhëheqësit e lartë të shtetit.



AKTAKUZË KUNDËR NJË PERSONI PËR KRIME LUFTE NË ISTOG

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj një personi i cili dyshohet se ka kryer veprën “krim i luftës kundër popullatës civile” në komunën e Istogut. T. P., sipas aktakuzës, gjatë periudhës së luftës në Kosovë në fshatin Cerrcë dhe fshatrat përreth në Istog, së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe, “ka kryer vrasje, plaçkitje dhe shkatërrim të pasurisë të civilëve shqiptarë”. T. P., i nacionalitetit serb, u arrestua më 12 shtator të vitit 2024. Ai akuzohet se në prill të vitit 1999 ka marrë pjesë në vrasjen e pesë anëtarëve të një familjeje. “Viktimat K. R., Z. R, R. R., I. R dhe Sh. R., nën

kërcënimin e armëve, janë detyruar të lënë shtëpinë e tyre dhe janë vendosur në një shtëpi tjetër, në të cilën më pas ishin vrarë. Sipas aktakuzës, shtëpia bashkë me trupat e viktimave është djegur”, u tha në njoftimin e Prokurorisë. Përveç vrasjeve, T. P. akuzohet se ka vjedhur pasuri të luajtshme dhe më pas ka djegur shtëpitë në fshatrat e kësaj komune. Së voni, Prokuroria Speciale ka ngritur disa akuza për krime që janë kryer gjatë luftës më 1998-99. Në gusht ajo dorëzoi në gjykatë një aktakuzë në mungesë kundër 21 të dyshuarve për dëbimin me forcë të më shumë se 800 mijë civilëve shqiptarë nga Kosova gjatë luftës.

Që nga përfundimi i luftës dhjetëra persona janë dënuar për krime lufte para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Nga viti 2000 deri më 2008 krimet e luftës në Kosovë janë hetuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008 nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX). Më 2018, EULEX-i dorëzoi lëndët në Prokurorinë e Kosovës dhe gjykatat vendore. Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-1999 janë vrarë më shumë se 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Afër 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.



NDAHEN MBI KATËR MILIONË EURO PËR PAGAT E 700 PUNËTORËVE TË RTK-së, KURTI E QUAN IMPROVIZIM TË DETYRUAR

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Qeveria në detyrë e Kosovës në mbledhjen e sotme ka marrë vendim për ndarjen e 4 milionë e 480 mijë euro për ekzekutimin e pagave për 700 punëtorët e RTK-së të cilët tash e disa ditë janë në grevë. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, tha se ky është improvizim i detyruar. “Siç e ka paralajmëruar këtë të hënë në konferencë ministri Hekuran Murati, kemi shqyrtuar disa opsione për të dalë nga kjo situatë. Sot këto mjete po ndahen nga kategoria e kursimeve. Kjo zgjidhje e sotshme apo më mirë të themi kjo mënyrë e tanishme është



vetëm një improvizim i detyruar pas përpjekjeve tona të vazhdueshme në Kuvendin e Kosovës për ta miratuar aty buxhetin për RTK-në”, tha Kurti.

Kurse ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, bëri me dije se këto mjete janë marrë si kursime nga projektet ekzistuese. “Ndarja e 4 milionë e 480 mijë euro për RTK të cilat

është dashur të kursehen ose merren si kursime nga projekte ekzistuese në kuadër të organizatave tjera buxhetore për shkak se në Kuvend u refuzua të krijohet Komisioni për Buxhet dhe të votohej buxheti për RTK. Në pamundësi që të sigurohen pagat e punëtorëve tash e sa kohë nga ana e Kuvendit si themelues i RTK-së na është dashur neve si Qeveri të marrim këtë hap improvizues që të gjendet një zgjidhje emergjente dhe të sigurohen pagat për transmetuesin publik”, tha Murati. Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka mirëpritur

vendimin e Qeverisë në detyrë të Kosovës për ta ndarë buxhetin për RTK-në nga kategoria e kursimeve. Në reagimin e tij, thuhet se ky vendim është një lehtësim i vonuar për 700 punonjësit e RTK-së dhe familjet e tyre. “AGK shpreh keqardhje që situata e pritjeve të gjata për paga është përsëritur dy herë brenda vitit. Edhe vendimi i sotëm është i përkohshëm. AGK-ja bën thirrje që financimi stabil i RTK-së të jetë prioritet në legjislaturën e re vitin tjetër, ashtu sikurse edhe zgjidhja e problemit me pronën përmes një ligji të ri”, thuhet në njoftimin e AGK-së.

Paraqitet Kurrikula e re për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme për moshën 0-6 vjeç

PRISHTINË, 27 NËNTOR (ER) - Ministria në detyrë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbëria Nagavci, së bashku me zëvendësministrin në detyrë të Arsimit, Arsim Ademi, morën pjesë në prezantimin e Kurrikulës së re për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (EFH) për fëmijët e moshës 0-6 vjeç, në kuadër të Konferencës Kombëtare “Së bashku për edukim cilësor në fëmijërinë e hershme”. Ministria Arbërie Nagavci theksoi se Kurrikula e re paraqet një vizion modern dhe gjithëpërfshirës i cili e vendos fëmijën në qendër të procesit mësimor. “E mbështetur në filozofinë e të nxënës përmes lojës, mirëqenies, zhvillimit holistik dhe kompetencat e

shkullit XXI, kurrikula është hartuar në përputhje me udhëzuesin e IBE-UNESCO-s”, u shpreh Nagavci. Ministria rikujtoi se edukimi në fëmijërinë e hershme mbetet prioritet kombëtar, i konsoliduar përmes Ligjit të ri për EFH dhe Strategjisë së Arsimit të Kosovës. Duke paraqitur investimet e realizuara, ministria njoftoi se MASHTI ka ndërtuar 14 çerdhe të reja, Bashkimi Evropian përmes BE-IPA ka mbështetur 6 të tjera, ndërsa 31 çerdhe janë aktualisht në ndërtim dhe dy në proces kontraktimi, ndërsa në buxhetin e vitit 2025 kanë qenë të planifikuara 19 çerdhe të reja. Ajo theksoi edhe qasjen inovative të adaptimit të objekteve shkollore në çerdhe,

deri tani 11 objekte janë shndërruar me sukses, 6 janë në proces dhe 4 të tjera janë planifikuar. Shefja e UNICEF-it në Kosovë, Veronika Vashchenko, e cilësoi lansimin e Kurrikulës si një moment historik për Kosovën, duke theksuar bazën e saj shkencore dhe rëndësinë kritike që kanë vitet e para të jetës për zhvillimin e trurit. Ajo u shpreh se kurrikula trajton fëmijët si individë kureshtarë, aktivë dhe kreativë, dhe përfaqëson një investim të mençur me përfitime të mëdha arsimore, sociale dhe ekonomike. Ndërsa ambasadori i Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz, vuri në pah rëndësinë e arsimit duke cituar Kofi Annan dhe theksoi partneritetin e



fuqishëm në mes të Luksemburgut, UNICEF-it dhe institucioneve të Kosovës që nga viti 2014. Ai nënvizoi se përkrahja për fëmijët më të cenueshëm ka qenë gjithmonë në qendër të bashkëpunimit

dhe e quajti lansimin e kurrikulës së re një hap transformues që pritet të sjellë rezultate më të mira në të nxënë, zhvillim socio-emocional dhe shëndet afatgjatë.

Rrahmani: Kosovës i duhet një kryeministër që bashkon, jo që përçan

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Një ditë më parë është zyrtarizuar koalicioni në mes të Partisë Demokratike të Kosovës dhe "Listës për Familje".

Prijësi i kësaj liste, Eman Rrahmani, ka thënë se Kosovës i duhet një kryeministër që bashkon, e jo që përçan. "Vazhdojmë angazhimin tonë politik me përkushtim të plotë, në shërbim të çdo qytetari të Republikës së Kosovës. Sot vendi ynë ka më shumë se kurrë nevojë për njerëz me integritet, dije dhe urtësi në përfaqësim, njerëz që e

vendosin interesin e qytetarëve mbi gjithçka. Në këto zgjedhje, ne do të garojmë si koalicion brenda listës së Partisë Demokratike të Kosovës, pas ftesës së kryetarit të PDK-së dhe kandidatit për kryeministër, z. Bedri Hamza, me të cilin kemi nisur këtë rrugëtim të përbashkët", ka shkruar ai të enjten në "Facebook".

Ai ka theksuar se Kosovës i duhet një qeveri që i hap vendit horizonte të reja ekonomike, një qeveri që mbron familjen, vlerat konservatore dhe stabilitetin shoqëror, një

leadership që e rikthen seriozitetin dhe besueshmërinë e shtetit tonë, si në rrafshin e brendshëm, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. "Familja është themeli i shoqërisë sonë. Ajo është vendi ku lindin dashuria, përgjegjësia dhe edukata qytetare. Ne do të angazhohemi për politika që e mbështesin familjen, që i japin dinjitet emrit nënë e babë, siguri ekonomike prindërve dhe perspektivë të rinjve tanë. Të forcojmë familjen do të thotë të forcojmë kombin", ka deklaruar Rrahmani.



LV-ja NOMINON KURTIN KANDIDAT PËR KRYEMINISTËR PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka nominuar kreun e partisë, Albin Kurti, kandidat për kryeministër të Kosovës në zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit. Kurti, ashtu siç pritej, mori besimin e të gjithë delegatëve të partisë gjatë një mbledhjeje të Këshillit të Përgjithshëm në Prishtinë. "Atëherë, konstatoj se me votat e të gjithë delegatëve të Lëvizjes, pra unanimisht, miratojmë propozimin që Albin Kurti të jetë kandidati ynë për kryeministër të Kosovës", tha Arbërie Nagavci, kryesuese e Këshillit të Përgjithshëm të partisë.

Duke folur pas nominimit, Kurti



tha se "ndihem i nderuar që edhe një herë më besuat si kandidatin tuaj për kryeministër".

Ai i kritikoi partitë e tjera në vend për mungesën e gatishmërisë për të

bashkëpunuar me partinë e tij pas zgjedhjeve të rregullta të 9 shkurtit. "Jemi para zgjedhjeve të reja pa vullnetin dhe dëshirën tonë, por si pasojë e refuzimit nga subjektet e tjera për të pasur çfarëdo bashkëpunimi me neve.

Së pari më refuzuan mua e pastaj edhe Glauk Konjufcën", tha Kurti.

Kurti bëri përpjekje disamuajshe për ta siguruar një mandat të tre në krye të vendit, por as ai e as bashkëpartiaqi i tij, Glauk Konjufca, nuk e morën mbështetjen e Kuvendit për ta bërë qeverinë e re muajt e fundit.

LV-ja i fitoi zgjedhjet e 9 shkurtit, por 48 vende në Kuvend ishin të pamjaftueshme dhe Kurti nuk arriti të gjejë një partner koalicioni, qoftë për ta arritur minimumin e kërkuar prej 61 ulëseve për një qeveri të pakicës. Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila ditë më parë e nominoi kreun e vet, Lumir Abdixhiku, për kryeministër në zgjedhjet e muajit të ardhshëm, kishte

oferta nga Kurti për të bashkëqeverisur, por ajo vazhdimisht i hodhi poshtë ato. Pasi Kuvendi nuk arriti ta votojë qeverinë e re, presidentja Vjosa Osmani e shpërbeu Kuvendin javën e kaluar dhe shpalli zgjedhje të parakohshme për 28 dhjetor. Si pasojë e mungesës së bashkëpunimit dhe lëshimeve politike, Kosova vazhdon të jetë me qeveri në detyrë që nga shkurti i këtij viti.

Vendi tani shkon në zgjedhje të reja duke mos miratuar marrëveshje ndërkombëtare në vlerë rreth 200 milionë euro, buxhetin e vitit të ardhshëm të shtetit, buxhetin për Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) dhe buxhetin për tri komuna - Prishtinë, Gjilan dhe Zubin Potok.

NËNSHKRUHET PLANI BILATERAL I BASHKËPUNIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES SË KOSOVËS DHE ASAJ TË ITALISË



PRISHTINË, 27 NËNTOR - Në Ministrinë e Mbrojtjes është zhvilluar takimi bilateral me delegacionin e Forcave të Armatosura të Italisë në kuadër të planifikimit vjetor të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.

Gjatë takimit palët finalizuan dhe nënshkruan Planin Bilateral Vjetor për vitin 2026, dokument i cili përcakton

aktivitetet, prioritetet dhe fushat e angazhimit të përbashkët për vitin e ardhshëm.

Plani është nënshkruar nga drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike, kolonel Ahmet Ajeti dhe përfaqësuesi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Italiane, kapiten

marine Manuel Verdini.

Gjatë qëndrimit në Ministrinë e Mbrojtjes, delegacioni italian zhvilloi një takim kortezie me drejtorin e Politikave të Mbrojtjes, Faruk Geci, ku u diskutua përparimi i bashkëpunimit aktual si dhe objektivat e përbashkëta për periudhën në vijim.

Të dy delegacionet riafirmuan vullnetin për zgjerimin e

bashkëpunimit, me theks të veçantë zhvillimin e kapaciteteve ushtarake dhe shkëmbimet profesionale ndërmjet personelit.

Ministria e Mbrojtjes dhe Republika e Kosovës vlerësojnë lart rolin dhe mbështetjen e Italisë në forcimin e institucioneve tona të mbrojtjes dhe në avancimin e standardeve të sigurisë.

Memli Krasniqi nuk garon për deputet në zgjedhjet e 28 dhjetorit

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Me vendim të Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi ka marrë përsipër përgjegjësinë për ta udhëhequr fushatën zgjedhore të kësaj partie, duke marrë detyrën e shefit të Shtabit Qendror Zgjedhor për zgjedhjet e jashtëzakonshme të 28 dhjetorit.

Krasniqi ka thënë se këto zgjedhje janë mundësi për t'i

rikthyer vendit normalitetin, stabilitetin dhe zhvillimin. Ai ka thënë se PDK-ja hyn në këtë proces më e përgatitur, e bashkuar dhe shumë e gatshme për t'i dhënë vendit drejtimin që meriton. "Në këtë fushatë, do të jem plotësisht në shërbim të fushatës sonë, të ekipit, të strukturave dhe të fitores sonë të përbashkët. Prandaj, pas shtatë mandateve si deputet i Kuvendit të Kosovës, këtë herë kam

vendosur që të mos jem pjesë e listës tonë zgjedhore. Ky është një vendim i qëllimshëm, që më lejon t'i përkushtohem tërësisht organizimit dhe udhëheqjes së fushatës dhe mbështetjes së plotë për kryetarin dhe kandidatin tonë për kryeministër, Bedri Hamza. Ecim bashkë, me besim dhe vendosmëri, për një Kosovë ma të mirë për të gjithë!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



Rritet kostoja e ndërtimit

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeks të Kostos së Ndërtimit (IKN) për tremujorin e tretë (TM3) 2025. Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 0,5 % në TM3 2025 krahasuar me TM2 2025. Ndërkaq, krahasuar TM3 2025 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak TM3 2024, Indeksi i

Kostos së Ndërtimit pati rritje për 3,6 %. Indeksi i tërësishëm i Kostos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për (0,5 %) në tremujorin e tretë (TM-3) 2025 krahasuar me tremujorin e dytë (TM-2) 2025. Rritje kishin energjia (3,9 %), pagat (2,3 %), kostot e tjera (1 %), materialet (0,1 %), ndërsa zbritje kishte te makineritë (-0,7

%). Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje (3,6 %) në tremujorin e tretë (TM-3) 2025 krahasuar me tremujorin e tretë (TM-3) 2024. Rritje më të madhe kishin energjia (9,7 %), pagat (7,8 %), kostot e tjera (4,5 %), transporti (3,4 %), materialet (2,9%), ndërsa zbritje kishte te makineritë (-0,4%).



ÇMIMET E PRODHIMIT, MË TË LARTA NË TREMUJORIN E TRETË TË KËTIJ VITI

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeks të Çmimeve të Prodhimit (IÇP) për tremujorin e tretë (TM3) 2025. Indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë në TM3 2025 krahasuar me TM2 2025 u ngrit prej 1,3 %. Po ashtu, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM3 2024), Indeksi i Çmimeve të Prodhimit u rrit për 5,5 %.


Tremujori i tretë 2025 - tremujori i dytë 2025, 1.3 %

Çmimet e prodhimit në Kosovë patën një ngritje prej 1.3 % në mes TM3 2025 dhe TM2 2025. Ngritjet më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: prodhimi tjetër p.k.t. 4.7 %, energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar 3.9 %, prodhimi i mobilie 2.7 %, prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t 2 %, prodhimi i pajisjeve elektrike 1.9 %, prodhimi i metaleve 1.3 %, përpunimi i produkteve ushqimore 0.7 %, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës 0.5 %, prodhimi i produkteve minerale jo metalike 0.2 %, nxjerrja e xehes së metalit 0.1 %. Ngritja u neutralizua nga rënia e çmimeve te: prodhimi i mjeteve motorike (të transportit),

rimorkiove dhe gjysme rimorkiove -2.9 %), grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë -1.7 %, prodhimi i tekstilit -1 %, xeherorët dhe guroret tjera -0.8 %, veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave -0.8 %, prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialet të gërshtuara -thurëse -0.4 %, prodhimi i pijeve -0.1 %, prodhimi i produkteve kimike -0.1 %, prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve -0.1 %.

Tremujori i tretë 2025 - tremujori i tretë 2024, 5.5 %

Çmimet e Prodhimit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 5.5 %, në mes të TM3 2025 dhe TM3 2024. Ngritjet më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: prodhimi i mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove 23.01 %, energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar 20.8 %, prodhimi i tekstilit 14.2 %, përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutike 8.1 %, prodhimi i veshjeve 7.9 %, prodhimi i mobilie 7.8 %, shtypja dhe



riprodhimi i mediave të incizuara 7 %, prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t. 5.1 %, prodhimi i pajisjeve elektrike 5 %, grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë 5 %, përpunimi i produkteve ushqimore 3.1 %, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës 2.9 %, prodhimi i drurit dhe i

produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialet të gërshtuara -thurëse 0.9 %, prodhimi i produkteve minerale jo metalike 0.4 %, prodhimi i produkteve kimike 0.1 %. Ngritja u neutralizua nga ulja e çmimeve te: prodhimi tjetër

p.k.t. -15.9 %, prodhimi i metaleve -10.4 %, xeherorët dhe guroret tjera -6 %, nxjerrja e xehes së metalit -2.5 %, prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës -1.7 %, veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve -1.5 %, prodhimi i pijeve -0.8 %.

Posta e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë thellojnë bashkëpunimin

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Kryeshefja ekzekutive e Postës së Kosovës, Nora Rraci, së bashku me bashkëpunëtorët, ka pritur në takim një delegacion nga Tirana, i kryesuar nga administratori i përgjithshëm i Postës Shqiptare, Etjen Xhafaj. Takimi u fokusua në fuqizimin e bashkëpunimit strategjik dhe identifikimin e fushave me potencial të lartë zhvillimor, duke përfshirë shkëmbimin e ekspertizës, zhvillimin e projekteve të integruara, shërbimet financiare dhe platformat e e-commerce. Kryeshefja ekzekutive, Nora

Rraci, gjatë bisedës theksoi se Posta e Kosovës ka konsoliduar procese, ka rritur cilësinë e shërbimeve dhe ka fuqizuar kapacitetet operacionale, duke zgjeruar praninë me zyra postare dhe operacione në tërë vendin. “Bashkëpunimi me Postën Shqiptare, në kuadër të strategjisë dhe mbi bazën e komplementaritetit, është një mundësi për të avancuar këto arritje, për të zhvilluar shërbime të reja dhe për të sjellë vlerë të drejtpërdrejtë për qytetarët, duke e pozicionuar Postën e Kosovës si një institucion modern dhe të besueshëm”, ka thënë ajo.

Administratori i Postës Shqiptare, Etjen Xhafaj, ka thënë se për të është kënaqësi ta thellojnë bashkëpunimin me Postën e Kosovës në një fazë të re dhe më të avancuar. “Synimi ynë është të zhvillojmë projekte të përbashkëta që e rrisin cilësinë e shërbimeve për qytetarët në të dy vendet. Së bashku mund të krijojmë standarde të reja në tregun postar dhe atë të e-commerce”, ka thënë Xhafaj. Në përfundim të takimit, delegacionet shkëmbyen dhurata simbolike në shenjë respekti dhe vlerësimi të bashkëpunimit të vazhdueshëm.



RIKTHIMI I KUFIJVE: LUFTË, EKONOMI, IDENTITET - JA PSE BOTA PO COPËZOHET SËRISH

Ndajnë dhe bashkojnë. Izolojnë dhe mbrojnë. Janë burimi i qytetërimit – dhe i luftërave. Dhe sot janë më të kontestuar se kurrë. Ja pse

Rusia që pushton Ukrainën. Lufta në Gaza. Brexit. Zgjerimi i NATO-s. Venezuela që zhvillon një referendum për aneksimin e Esequibo-s, territor i Guajanës. Ka një element që lidh të gjitha këto situata kaq të ndryshme (dhe lista mund të vazhdojë): janë të gjitha çështje kufijsh. Ironikisht, rënia e Murit të Berlinit në vitin 1989 u përshëndet si fundi i të gjitha kufijve... Por nuk ndodhi kështu. Përkundrazi, llogarisin gjeografët, për çdo kilometër të Murit të Berlinit të shembur, vetëm në Evropë janë ngritur 172 km kufij të rinj. Shkak ishte shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, që çliroi nacionalizmat e shteteve satelite (Letonia, Estonia, Lituania, Çeçenia...).

Mjafton të kujtojmë se fjala “Ukrainë” vjen nga krajina, “kufi”, sepse ishte periferia jugperëndimore e perandorisë ruse. Sot kufijtë po vihen në pikëpyetje kudo. Partneritetet tregtare transatlantike dhe transpacifike, të krijuara për të ulur barrierat doganore dhe për të nxitur tregtinë, janë bllokuar, ndërsa tarifatat mes Kinës, Europës dhe SHBA-ve rriten. Institucionet e mëdha ndërkombëtare (OKB, OBSH) janë në krizë, dhe shumë vende po ringjallin sovranizmin dhe proteksionizmin.

Përse po ndodh kjo? Dhe ku do të na çojë? Për t’u përgjigjur, duhet të kthehemi pas dhe të kuptojmë lindjen e kufijve.

Identitet dhe tensione

Historia e gjatë e Perandorisë Romake filloi, sipas legjendës me Romulin, i cili vizatoi me parmendë një brazdë në tokë: kufirin e parë të Romës, mbi të cilin u ngrit një mur mbrojtës. Por kufijtë janë shumë më të hershëm. Ato lindën rreth 10 mijë vjet më parë, kur komunitetet u bënë të qëndrueshme falë bujqësisë dhe blegtorisë në “Gjysmëhënën pjellore”: luginat e Tigris, Eufratit dhe Nilit.

Rreth mijëvjeçarit IV p.e.s. lindën qytet-shtetet sumere dhe, siç kujton Manlio Graziano nga Sciences Po, “me to lindi nevoja për të përcaktuar hapësirën politike midis një qyteti dhe tjetrit dhe për të kontrolluar tokat përreth, që ishin jetike për mbijetesën”. Kështu lindën kufijtë natyrorë dhe muret mbrojtëse. Sipas Yuval Noah Hararit, kufijtë u mundësuan komuniteteve sedentare të krijonin vlera të përbashkëta, ligje, fe, monedhë, pa



të cilat shoqëritë e mëdha nuk do të funksiononin. Por ato sollën edhe tensione: kur një grup kalonte kufirin e tjetrit për të marrë burime, lindnin luftërat e para. Në British Museum, është një kolonë guri 4.500 vjeçare, një shenjë kufiri mes qyteteve sumere Lagash dhe Umma. Mbi të shkruhet një paralajmërim i prerë: kushdo që kalon kanalin e kufirit për të marrë tokën e tjetrit “qoftë i shkatërruar nga Enlili”.

Ky është kufiri më i vjetër i njohur. Sot, kufijtë tokësorë të 193 kombeve përbëjnë rreth 250 mijë km, më shumë se 6 herë rreth e rrotull botës. Dhe u shtohen kufijtë detarë, nëntokësorë dhe ajrorë.

Kufijtë përcaktojnë terri-tore, dhe komunitete

Kufiri është linja e përbashkët që ndan dy territore, por edhe i lidh. Ndërsa “frontiera” është koncept luftarak: aty përballen ushtritë. Kufiri është dinamik, jo gjithmonë i mbyllur. Mund të lëvizë, të jetë poroz.

Michel Foucault thoshte se kufiri është “mekanizëm që rregullon raportin midis brendësisë dhe asaj që shihet së jashtmi, midis përfshirjes dhe përjashtimit”. Pra, ai përcakton një territor dhe një komunitet që ndan gjuhë dhe

kultura. Janë gjithmonë pak a shumë arbitrarë. Në ngushticën e Beringut, dy ishujt Diomede janë vetëm 5 km larg, por ndahen nga 21 orë kohë, sepse aty kalon vija ndërkombëtare e datës. Njëri quhet “ishulli i djeshëm”, tjetri “ishulli i nesër”.

“Rendi i ri” i vitit 1648

Për shekuj të tërë, kufijtë ishin të paqartë. Në kulmin e saj në vitin 117, Perandoria Romake përdorte kryesisht pengesa natyrore dhe disa mure si Vallo i Hadrianit. Në Mesjetë, territoret mbivendoseshin dhe autoritetet ishin të shumëfishta. Pushteti nuk përkufizohej nga një vijë, por nga sa larg shtrihej aftësia për të mbledhur taksa dhe për të siguruar besnikëri ushtarake.

Kufijtë që njohim sot lindën me Paqen e Vestfalisë (1648), e cila vendosi parimin e sovranitetit: një autoritet ka fuqi të plotë brenda kufijve të vet. Prej aty filloi gara për të vizatuar kufij të qartë. Vendi që përfitoi më shumë ishte Mbretëria e Bashkuar. E mbrojtur nga deti, ajo zhvilloi një sistem politik më përfshirës dhe një ekonomi konkurruese që çoi drejt Revolucionit Industrial. Sukses i lidhur ngushtë me mbrojtjen e kufijve.

Modeli britanik dhe lindja e nacionalizmit

Por kufijtë britanikë ishin porozë, dhe modeli u përhap në Europë. Së bashku me zhvillimin industrial, lindi nacionalizmi, që “shenjoi kufirin si simbol të vlerave të brendshme kundër barbarisë së jashtme”. Nga këtu te lufta, rruga është e shkurtër.

Kufijtë, gjeopolitikë, ekonomikë, kulturorë, nuk janë të mirë as të këqij. Ata krijojnë mundësi dhe konflikte. Sipas studiuesve, tensionet shpërthejnë kur këto tre kufij nuk përputhen më. Ndërsa periudhat e prosperitetit ndodhin kur ato përkojnë.

Mallrat (dhe qytetarët) e botës

Pas Luftës së Dytë Botërore, lindi ideja se tregtia e lirë do t’i bënte kufijtë ekonomikë të panevojshëm. U krijuan OKB-ja, OBT, Banka Botërore, Komuniteti Ekonomik Europian, ASEAN, Mercosur. Rënia e barrierave çoi në rritje ekonomike dhe ulje drastike të varfërisë ekstreme. Por globalizimi solli konkurrencë të fortë dhe presione për industrinë perëndimore.

Krizat financiare, pakënaqësia dhe frika nga e ardhmja ushqyen

nacional-populizmin: Brexit, trumpizmi, sovranizmi. Kur njerëzit ndihen të kërcënuar, kërkojnë fajtorë: mallrat e huaja, migrantët, tregjet e hapura. Sot, ndarja më e mprehtë është ajo ekonomike: midis atyre që mund të lëvizin lirshëm dhe atyre që nuk mundin.

Çështjet globale nuk njohin kufij

Pandemitë, ndryshimet klimatike, terrorizmi, ciklonet, krizat energjetike, asnjë prej tyre nuk respekton kufijtë kombëtarë. Rendi global pas Jaltës nuk funksionon më. SHBA-të nuk arrijnë të stabilizojnë sistemin ndërkombëtar si dikur. Kina nuk mund të ndërtojë një rend të ri sepse i mungon legjitimiteti. Sipas ekspertëve, vetëm një qeverisje globale që përfshin aktorë të rinj, Gjirin Persik, Brazilin, Indinë, Turqinë, Indonezinë, Meksikën, Nigerinë, mund të shmangë fragmentimin në makro-rajone konkurruese dhe potencialisht armiqësore.

Interneti është sot e vetmja hapësirë pa kufij, një komunitet global, por edhe i cenueshëm ndaj manipulimit dhe algoritmeve që krijojnë “filuska informacioni”. / focus – bota.al

PSE GRUAJA DHE DJALI I SHEKSPIRIT MBETEN ENDE NJË MISTER

Filmi i ri Hamnet, që po përflitet për çmime Oscar, paramendon jetën familjare të Uilliam dhe Agnes Shekspir - dhe humbjen e djalit të tyre. Është një histori prekëse që mbush shumë boshllëqe.

Nga: Caryn JAMES / BBC

Në Hamnet - romani i elokuent i Maggie O'Farrellit nga viti 2020 dhe filmi i ri i bazuar mbi të - grua e Shekspir (William Shakespeare), Agnes, paraqitet si herbaliste që njeh mjekësinë natyrore dhe ka aftësi pothuajse të mbinatyrshme për të ndier të ardhmen. Por, ajo nuk arrin ta shpëtojë djalin e saj të vogël nga murtaja - një vdekje që e shtyn të atin e djalit të shkruajë një nga veprat më të mëdha të letërsisë: Hamletin. Dhe, thuajse asgjë nga kjo nuk është e vërtetuar. Në letër dhe në ekran, Hamneti është një vepër e imagjinatës, një eksplorim i thellë i dhimbjes dhe humbjes, i ndërtuar mbi pak fakte të njohura. Nuk mund të thuash se O'Farrell - që ka shkruar gjithashtu edhe skenarin e filmit bashkë me regjisorin Chloé Zhao - ka shtrembëruar të vërtetën, sepse nuk ekziston një histori e dokumentuar, pavarësisht përpjekjeve shumëvjeçare të historianëve për të zbardhur të kaluarën e Shekspir.

Faktet e pakta rreth familjes së Shekspir janë shumë më të pakta në numër nga pyetjet që ato ngrenë. Regjistrimet tregojnë se në vitin 1582, Ulliam Shekspiri, atëherë 18 vjeç, u martua me 26-vjeçare Anne Hathaway, e cila ishte shtatzënë me fëmijën e tyre të parë, Susanna. Tre vjet më vonë lindën binjakët e tyre, Judith dhe Hamnet - një emër që në atë kohë përdorej në mënyrë të ndërrueshme me Hamlet. Në vitin 1596, kur ishte vetëm 11 vjeç, Hamneti vdiq. U varros më 11 gusht, dhe është pothuajse e sigurt që Shekspiri, i cili ndodhej në udhëtim me trupën e tij teatrale, nuk ka mundur të kthehet me kohë në Stratford për funeralin. Rreth katër vjet më vonë, ai shkroi Hamletin. Nxirrni çfarë të doni nga kjo. Askush nuk e di nëse Shekspiri u detyrua të martohej me Annen sepse ajo ishte shtatzënë, apo nëse ishin lidhur vërtet nga dashuria. Askush nuk e di saktësisht si vdiq Hamneti, por murtaja ishte përhapur shumë në atë kohë dhe është shkaku më i mundshëm. Më e rëndësishmja për librin dhe filmin, askush nuk di shumë për vetë Annen, përfshirë nëse ajo dinte të lexonte e të shkruante. Letërsia ia jep asaj një personalitet të fortë (siç e

portretizon fuqishëm Jessie Buckley në një rol që pritet të nominohet për Oscar), dhe një romancë pasionante me Shekspirin (të luajtur nga Paul Mescal). Në të vërtetë, Hamneti flet për Agnesën. Në shënimet e autores në fund të romanit, O'Farrell pranon se dihet shumë pak për Hamnetin dhe prindërit e tij. Por, ajo e mbush rrëfimin e saj me kërkime të kujdesshme për fundin e shekullit XVI, duke e vendosur ngjarjen në kontekstin historik. Gjatë hulumtimit, ajo i tha BBC-së: "U tërhoqa paksa nga mënyra se si historia dhe studimet akademike e kanë trajtuar keq gruan e Shekspir, gruan që na mësuam ta quajmë Anne Hathaway. Na është dhënë vetëm një version për të, dhe shumica e biografëve thjesht janë pajtuar me të - se ajo ishte një fshatare analfabete e cila e detyroi atë në martesë, se ai e urrente, se iku në Londër për të qenë larg saj". Edhe emri i saj është i pasigurt. Babai i saj, një fermer i suksesshëm, ia la asaj një pajë në testament, duke e quajtur Agnes. O'Farrell zgjodhi t'ia japë personazhit të saj këtë emër, duke arsyetuar: "[nëse] ndokush do ta dinte emrin e saj, do të ishte i ati." Ajo thotë: "U ndje vërtet si simbolikë që, përveç gjithçkaje tjetër, nuk kemi arritur as emrin t'ia dimë saktë." O'Farrell ka një argument të fortë sa i përket demonizimit të gruas së Shekspir. Jo Eldridge Carney, autore e studimit Gratë i kundërpërgjigjen Shekspir: Adaptime dhe përshtatje bashkëkohore dhe



Ilustrim: Shekspiri duke recituar "Hamletin" për familjen e tij (Burimi: Alamy)

profesoreshë e gjuhës angleze në Kolehshin e Nju-Xhersit, i tha BBC-së: "Ky portretim nga O'Farrelli është mohim i qëllimshëm i shekujve të paragjykimeve dhe supozimeve të pabazuara për Annen - qoftë si shenjto e duruar, por e mërzitshme, që ruante vatrën në Stratford, qoftë si grua e përdalë që e joshi Shekspirin në një martesë të mjerë." Zbulimi i emrit të saj të vërtetë është më i ndërlikuar. David Scott Kastan, një studiues i njohur i Shekspir dhe profesor emeritus i anglishtes në Universitetin Jejlit, i tha BBC-së: "Në thuajse të gjitha dokumentet ajo quhet Anne, dhe vetëm në një - testamentin e të atit - quhet Agnes." Asgjë tjetër nuk është e sigurt. Është e mundur, thotë ai, "që ajo të jetë pagëzuar Agnes, por të jetë

quajtur Anne." Ai shton: "Më pëlqen mënyra se si romani e shfrytëzon këtë mundësi për t'ia dhënë asaj një identitet të vetin, të ndarë nga martesja për të cilën dimë shumë pak dhe që gjithnjë e shohim përmes lentes së Shekspir." Për të krijuar personazhin e veçantë të Agnesës, O'Farrell e përpunoi atë nga dramati e Shekspir. "Ajo çfarë bëra ishte të kthehesha te dramati dhe t'i rilexoja në një mënyrë tjetër, duke parë nëse mund ta gjeja aty - sepse gjithnjë kam ndier se e shoh Hamnetin te Hamleti. Por, pyesja veten - mendoja se duhej të ishte diku." Një frymëzim për intuitën e Agnesës vjen nga këto rilexime. "Ka shumë vizione dhe parandjenja në dramë," thotë O'Farrell. "Mendo për shembull për orakullin te Jul

Cezari." Njohuritë letrare të Agnesës për bimët dhe ilaçet kanë gjithashtu një paralelizëm me dramati e Shekspir - veçanërisht në monologun e Ofelisë te Hamleti, kur ajo duket se humb mendjen dhe u shpërndan lule e bimë personazheve të tjerë, duke përmendur vargjet: "Rozmarina është për kujtesën." "Lexova që çdo shtëpi, në atë kohë, kishte një kopsht mjekësor," thotë O'Farrell. "Dhe, do të ishte përgjegjësi e gruas së shtëpisë, matriarkes, të dinte si të përgatiste ilaçe dhe të trajtonte sëmundjet. Nuk ishte diçka që burrat dinin." Për këtë pjesë të dialogut, O'Farrell thotë se mund të paramendohet se Shekspiri është mbështetur te njohuritë e gruas së tij. Të shohësh Agnesën si partnere të barabartë në martesë, kjo na ofron - ndoshta si një dëshirë e fshehtë - një Anne/Agnes për shekullin XXI. Agnesa e Buckleyt është lloji i gruas që mund të donim që Shekspiri të kishte - që është e veçantë në mënyrën e saj. Ajo është aq e pazakontë sa që përflitet, siç paralajmëron nëna e Shekspir në film, se është "fëmijë i një magjistareje të pyllit." Është e mençur, me bindje të forta dhe mjaft e kuptueshme për ta pranuar se burri i saj duhet të ndjekë thirrjen e tij artistike në Londër. Ajo është një grua për të cilën gjeniu mund të kishte rënë në dashuri - dhe ne kuptojmë se pse Shekspiri i Mescalit ndien një tërheqje ndaj saj që në fillim. Ky konceptim i Anne/Agnesës nuk është domosdo një dëshirë



Paul Mescal dhe Jessie Buckley interpretojnë Uilliam dhe Agnes Shekspirin në filmin "Hamnet" (Burimi: Alamy)

romantike. Carney thotë: “Edhe pse mund të jetë joshëse ta shohim Annen e O’Farrellit si përpjekje për ta kthyer atë thjesht në një feministe të epokës së hershme moderne - një figurë më e përputhshme me ndjesitë tona - ky portretizim, në fakt, përputhet me atë që dimë për jetën e shumë grave të asaj kohe.” Ajo shton: “E dimë se shumë gra drejtonin me sukses atë që sot do ta quanim ‘biznes të vogël’: prodhimin e birrës, mjekësinë bimore, përpunimin e elbit, tregtinë, endjen dhe më shumë. Shkalla e edukimit të nevojshëm për këto profesione ka qenë më e vështirë për t’u vlerësuar.”

Ne ende nuk e dimë nëse gruaja e Shekspirit dinte të lexonte. Agnesa fiktive, në roman, mundet, por vetë O’Farrell mendon se në versionin real të saj ajo ka qenë ndoshta analfabete. “Do të ishte e kotë të edukohej vajza e një blegtori për të shkruar dhe lexuar,” thotë ajo.

Martesa që përshkruhen në libër dhe në film, bëhet më e distancuar kur Shekspiri largohet nga familja për periudha të gjata kohore, duke jetuar në Stratford-mbi-Ejvën ndërsa punon në teatër në Londër - mungesa që janë historikisht të dokumentuara. Por, kur bëhet fjalë për vdekjen e Hamnetit dhe pasojat e saj të dhimbshme, ka vetëm spekulim.

O’Farrell, në përputhje me esenë me ndikim të studiuesit të Shekspirit, Stephen Greenblatt, Vdekja e Hamnetit dhe krijimi i Hamletit (2004), sheh një lidhje të drejtpërdrejtë me dramën, përtej ngjashmërisë së emrit. Në film, kur Agnesa udhëton drejt Londrës për ta parë vetë dramën - një shtesë e sajuar artistike - ne shohim, ashtu si ajo, se aktori që luan Hamletin është veshur dhe stilizuar që të ngjajë me Hamnetin. Në një zgjedhje brilante të kastit, Jacobi Jupe luan djalin



Ky vizatim në formë portreti nga viti 1708, është imazhi i vetëm i mbijetuar që mund të paraqesë gruan Anne Hathaway - ose Agnes, siç quhet në film.(Burimi: Getty Images)

Hamnet, ndërsa Noah Jupe, vëllai i tij, luan Hamletin në skenë. Ngjashmëria vizuale mes tyre është e padiskutueshme. Në këtë interpretim, drama nuk është vetëm një mënyrë për Shekspirin për të shprehur pikëllimin e tij - por, edhe një mundësi për t’ia thënë

lamtumirën të birit në skenë, ashtu siç nuk mundi ta bënte në jetë. Kastan thotë për lidhjen mes vdekjes së Hamnetit dhe dramës: “Ajo patjetër duhej të kishte një ndikim - thjesht nuk e dimë se çfarë ishte. Është joshëse, ndoshta e parezistueshme, ta lidhësh

vdekjen e djalit me Hamletin. Vdekja e Hamnetit/Hamletit duhet të jetë ndier nga Shekspiri dhe familja e tij si humbje shkatërrimtare për shpirtin. Mund të ketë qenë, të paktën pjesërisht, arsyeja se pse, brenda pak vitesh nga vdekja e djalit, Shekspiri iu kthye një drame të vjetër

(ndoshta nga Thomas Kyd) për një djalë të quajtur Hamlet dhe një fantazmë që thërret për ‘hakmarrje’ - për të shkruar Hamletin e tij, në të cilin do të interpretonte edhe vetë.” Është spekuluar prej kohësh se Shekspiri vetë e luajti rolin e fantazmës në dramën e tij - duke përmbysur rolet mes të gjallit dhe të vdekurit. Por, ka shumë ndikime të tjera në dramë, si letrare, ashtu edhe kulturore. “Lidhjet mes ngjarjeve të jetës dhe artit të Shekspirit janë thjesht spekulime - sado intriguese që janë,” thotë Kastano.

Fakti është që nuk ekziston asnjë provë e mbijetuar që të tregojë se çfarë ka menduar apo ndier Shekspiri për gruan dhe familjen e tij - as edhe një copë letre. Por, studimet e reja mbi një fragment letre nga një dërgues i panjohur, mund të hedh ose të mos hedh dritë mbi martesën e Shekspirëve. Matthew Steggle, profesor i gjuhës angleze në Universitetin e Bristolit, sugjeron se një letër drejtuar “Zonjës Shekspir” në Londër, mund të ketë qenë për Annen. Kjo do të nënkuptonte se ajo ka jetuar në Londër me burrin e saj midis viteve 1600 dhe 1610 - dhe do të dëshmonte se ajo dinte shkrim-lexim. Vetë Steggle ka thënë se kërkimi i tij thjesht “hap derën” ndaj kësaj mundësie, se “është një mundësi që duket e vështirë për t’u mohuar, por jo e sigurt.” Megjithatë, më shumë sesa çdo kërkim studimor, ky film me vlerë ka më shumë gjasa të ndryshojë perceptimin publik për gruan e Shekspirit, duke e përforcuar atë si Agnes. Kjo do të ishte “shumë bukur, nëse është e vërtetë,” thotë O’Farrell.


Por, “ndoshta do të jetë një gjë kalimtare. Ndoshta, ashtu si kjo letër, do të dalë në dritë diçka tjetër dhe të gjithëve do të na duhet të ndryshojmë mendim përsëri.” Ajo shton dy fjalët që përkufizojnë aq shumë nga ajo që dimë për Shekspirët dhe për djalin e tyre: “Kush e di?” /Telegrafi/



Ilustrim i shekulli XIX: Shekspirit duke recituar “Hamletin” për familjen e tij, me gruan ulur në karrige djathtas dhe djalin e tij, Hamnet, pas tij në të majtë (Burimi: Alamy)



Kulmi emocional i filmit “Hamnet” ndodh kur Agnesa udhëton drejt Londrës për të parë vetë Hamletin(Burimi: Alamy)



Ademi takon gjeneratën e artë të Prishtinës: Luftuan dhe mbajtën gjallë frymën e futbollit

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, me emocion të madh i ka pritur në takim disa nga ish-futbollistët e gjeneratës së artë të FC Prishtina. Ademi ka vlerësuar lart kontributin e tyre, duke thënë se këta janë historia e futbollit të Kosovës. “Këto legjenda janë historia jonë.

Janë ata që kanë sakrifikuar, kanë luftuar dhe kanë mbajtur gjallë frymën e futbollit kur ishte më së vështiri. Me zemër, me pasion dhe me dinjitet, ata e kanë ngritur këtë sport aty ku është sot. T’i kem pranë, t’i dëgjoj fjalët e tyre plot kujtime e dashuri, ishte pa dyshim ndjenjë e veçantë”, ka thënë Ademi. Ai ka theksuar se kjo gjeneratë

nuk është thjesht një emër, është trashëgimi e pasur e futbollit tonë. “Dhe sot më kujtuan edhe një herë pse duhet të punojmë çdo ditë me përkushtim për futbollin tonë. Faleminderit për vizitën, për përkrahjen dhe për gjithçka keni dhënë për fanellën, qytetin dhe vendin tonë ndër dekada”, ka thënë Ademi.



QEVERIA NDAN 250 MIJË PËR KOMBËTAREN E KOSOVËS, ZOTOHET EDHE PËR NJË MILION NËSE KUALIFIKOHET NË BOTËROR

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, gjatë mbledhjes së qeverisë ka njoftuar se qeveria ka ndarë 250 mijë euro për Kombëtaren e Kosovës pasi ka arritur në fazën e “play off”-it për kualifikim në Kupën e Botës 2026. Kurti është zotuar se do t’i ndajë 500 mijë euro në rast të fitores së Kosovës ndaj Sllovakisë, ndërsa një milion nëse Kosova kualifikohet në Botëror. “Një lajm të mirë e kemi për përfaqësuesen tonë në futboll, për djemtë me të cilët jemi krenarë në çdo ndeshje. Për suksesin historik në këtë fushatë të kualifikimeve në kupën e Botës 2026, kalimin në fazën e ‘playoff’, me vendim të

qeverisë sot do të ndajmë 250 mijë euro shpërblim. Në fazën e radhës hyjmë me plot vetëbesim e besimin tonë në ta po e shprehim me zotimin tona për ta. Së pari, në rast të fitores ndaj Sllovakisë, zotohemi për shpërblim në vlerë prej 500 mijë eurove. Dhe, së dyti, në rast të kualifikimit në Kupën e Botës, zotohemi edhe për një milion euro shpërblim. Përpara Kosovë, gjithmonë me ty”, ka thënë Kurti gjatë mbledhjes. Pas këtij vendimi, presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka falënderuar qeverinë në detyrë për ndarjen e 250 mijë eurove për Kombëtaren e Kosovës në futboll. Ai ka thënë se shpërblimet e caktuara nga



ekzekutivi për motivimin e ekipit para ndeshjeve të radhës përbëjnë një shtysë të fuqishme për futbollistët tanë të cilët janë të përqendruar dhe të motivuar

maksimalisht që ta çojnë Kosovën drejt objektivit historik, sigurimit të biletës për Kupën e Botës. “Kjo mbështetje institucionale është dëshmi e

besimit të plotë në punën, përkushtimin dhe rrugëtimin që po e ndërtojmë së bashku. Shpërblimet e caktuara nga ekzekutivi për motivimin e ekipit para ndeshjeve të radhës përbëjnë një shtysë të fuqishme për futbollistët tanë, të cilët janë të përqendruar dhe të motivuar maksimalisht që ta çojnë Kosovën drejt objektivit historik, sigurimit të biletës për Kupën e Botës. Falënderimi ynë shkon për të gjithë ata që po qëndrojnë krah Kombëtares dhe futbollit kosovar. Kjo mbështetje është jetike në këtë fazë vendimtare, ku çdo detaj dhe çdo motivim ka rëndësi. Bashkë po e shkruajmë historinë!”, ka shkruar Ademi në “Facebook”.

MBAPPE FUTET NË HISTORI TË LIGËS SË KAMPIONËVE PAS HET-TRIKUT NDAJ OLYMPIACOSIT



MADRID, 27 NËNTOR - Kylian Mbappe ka zhvilluar një nga paraqitjet më spektakolare individuale në historinë e Ligës së Kampionëve, duke shënuar një het-trik brenda më pak se shtatë minutave ndaj Olympiacosit. Me këtë het-trik është përmbysur disavantazhi i papritur prej 1-0 në një epërsi 3-1 në stadiumin “Georgios Karaiskakis”.

Francezi, i cili tashmë numëron 26 gola dhe gjashtë asistime në 22 paraqitje në të gjitha kompeticionet këtë sezon, ka barazuar shifrat në minutën e 22-të, pasi goli i hershëm i Chiquinhos kishte tronditur madrilenët. Mbappe ka shënuar edhe dy herë radhazi pak minuta më vonë. Statistikat tregojnë se ai tani ka shënuar më shumë hat-trick se çdo lojtar tjetër në

historinë e Ligës së Kampionëve (4). Mbappe e ka lënë pas legjendën e Real Madridit, Karim Benzema, me numrin e hat-trick-eve në Ligën e Kampionëve. Po me golin e katërt, 26-vjeçari ka tejkaluar edhe nisjen më të mirë të Cristiano Ronaldos në një sezon të Ligës së Kampionëve. Portugezi kishte realizuar tetë gola në pesë paraqitjet e para në

kontinent në sezonet 2013/14 dhe 2017/18, shifër që këtë sezon është tejkaluar nga nëntë gola të Mbappes në pesë ndeshje. Po ashtu, het-triku i Mbappes është i dyti më i shpejtë në historinë e kësaj gare (6 minuta e 42 sekonda), duke u renditur menjëherë pas rekordit të Mohamed Salah kundër Rangersit (6 minuta e 12 sekonda).

Neymari pëson lëndim të rëndë, mund të mos paraqitet në Botërorin 2026

Brasilia, 27 nëntor - Makthi i Neymarit vazhdon pa fund, pasi ylli brazilian ka pësuar një këputje të meniskut në gjurin e majtë gjatë ndeshjes së fundit kundër Santos, duke i mbyllur praktikisht sezonin. Dëmtimi i radhës e ka goditur në

momentin më të keq të mundshëm, pasi skuadra e tij po lufton për mbijetesë dhe ai nuk do të jetë i gatshëm t’i ndihmojë në javët vendimtare. Karriera e O’Ney prej vitesh është shndërruar në një betejë të përhershme me problemet

fizike: që nga sezoni 2013/14 ai ka pësuar plot 45 dëmtime, ka munguar për 1 429 ditë dhe ka humbur 265 ndeshje, një bilanc që e përshkruan qartë mallkimin që duket se e ndjek kudo. Tani rrezikohet edhe objektivi më i madh i tij, Kupa e Botës 2026.

Brazilit i Ancelottit mund t’i duhet të planifikojë gjithçka pa të, pasi koha e rikuperimit pas një dëmtimi të tillë është e gjatë dhe asgjë nuk garanton se ai do të arrijë në formën e duhur. Për Neymarin është një tjetër goditje e rëndë në një karrierë të



jashtëzakonshme, por të shoqëruar nga pengesa të pafundme.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të U.D.të Kryeshefit Ekzekutiv të datës 21.11.2025 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M.U niteti”S h.A, vendosi që më datë 27.11.2025 të shpall:

KONKURS I BRENDSSHËM

Udhëheqës i Kontabilitetit- në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.
Numri i referencës: 21-11-454
Përgatitja profesionale: Fakultetin Ekonomik
Përvoja e punës: Së paku 3(tri) vite përvojë pune në Sektorin e Financave
Njohja e punës me kompjuter Word &Exel, si dhe pogramme Softuerike
Lartësia e pagës mujore: 680.00 €Brut o

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon punët e kontabilitetit, kujdeset për sistemin e përgjithshëm të kontabilitetit në mënyrë që të siguroj regjistra të pasurive, borxheve dhe transakcioneve financiare.
- Bënë regjistrimin e pasurisë, të amortizimit, llogaritë e obliguara ligjore, të hyrat dhe të dalurat, harton raportet dhe informatat e nevojshme zyrtare,
- Kujdeset me kohë që mos të parashkruhen borxhet dhe kujdeset për zbatimin e dispozitave materijale ligjore nga lëmia e kontabilitetit.
- Bënë hartimin e llogarive periodike dhe të llogarisë përfundimtare të ndërmarrjes.
- Kontrollon rregullësin e operacioneve të kontabilitetit, të përmbajtjes së afatit dhe jep udhëzime të nevojshme profesionale si dhe kontrollon punën e punëtorëve në punë të kontabilitetit.
- E harton dhe azhuron planin analitik kontabël.
- Përmbledh dhe realizon informata për të përgatitur raporte financiare.
- Është përgjegjës për formalitetin dhe saktësinë e çdo dokumenti në bazë të të cilit krijon kërkesat dhe obligimet e ndërmarrjes.
- Përpilon proceset mbi barazimin e gjendjes të librave me shfrytëzuesit dhe partnerët afarist dhe atë në mënyrë analitike për çdo faturë dhe pagesë.
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të ZKF- së dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:
Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.
Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).
Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe ne bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.
